

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragash
03 Nr. Br. 400-28452
27-11-24
Dragash - Dragash

KONTRATË

Date: 27.11.2024.

Numri i kontratës¹: 621-24-11438-1-3-6/C985

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe
PM GROUP SH.P.K., Anton Çetta, PRISHTINË, (ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike përfurnizimet e shënuara me poshtë:

•110•Furnizimi me material higjenik (material pastrimi) ne Komunën e Dragashit me numër identifikues: 621-24-11438-1-3-6, dhe nr, te mbrendshem 621-2024-110-136.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
1	•110•Furnizimi me material higjenik (material pastrimi) ne Komunën e Dragashit

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor përdorëzim do të jetë 20 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues, ose deri me date **17.12.2024**.

2.2 Vend i dorëzimit të furnizimit do të jetë **K.K-Dragash**

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë .

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **3,366.50 €**; (tre mij e treqind e gjashtedhjete e gjashte Euro e pesedhjete cent).

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtronen ndryshimeve]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: [shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparrësise i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Kjo marrëveshje e kontratës;

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;
- (f) [shëno çdo dispozitë tjeter të dosjes së tenderit].

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetër; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendos" "do të shenohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën ³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një originale për Furnizuesin.


Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Nuro ismaili <i>110/2024</i>
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	<i>Smaili</i>
Data:	27.11.2024.
Vula:	



Për Furnizuesin

Emri:	PM GROUP SH.P.K., Anton Cetta, PRISHTINË
Pozita:	<i>Ergj</i>
Nënshkrimi:	<i>Ergj</i>
Data:	27.11.2024.
Vula:	



³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 621-24-11438-1-3-6/C985

Neni 1 Përkuqizimet

- 1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.
- 1.2 "Produktet" përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.
- 1.3 "Autoriteti Kontraktues" do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.
- 1.4 "Furnizues" do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.
- 1.5 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 1.6 "Inkotermet" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.
- 1.7 "Furnizim" do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhë paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 1.8 "Çmimi i kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tillë dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.
- 1.9 "Shërbimet pas shitjes" do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrimet e ngashme në lidhje me furnizimet e produkteve.
- 1.10 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.11 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përshtatje apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënes së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjeter i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprosimativ i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjeter financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Furnizuesi duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë punc nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk

nënkontrakton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përm bushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhë të agentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkthazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përsitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues përmarrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës se Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues përmarrjen mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuar apo licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuar apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontraten me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu eksposuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fugu në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontraten si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëllqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Prejardhja

8.1 Furnizuesi do të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes në momentin e pranimit të përkohshëm. Nëse ky obligim nuk plotësohet, kjo do të çojë në ndërprerje të kontratës, me paralajmërim zyrtar.

Neni 9 Siguria e ekzekutimit

9.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri përekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues përfshirë humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

9.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënës në pjesën IV të kontratës.

9.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës se perkohshme të pranimit.

Neni 10 Sigurimi

10.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet te jene te siguruara plotësisht me një valute lirisht te konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit te rastësishëm te prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj ne mënyrën e specifikuar ne KVK.

10.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 10.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 11 Programi i realizimit

11.1 Nëse kërkohet në KVK, Furnizuesi do të dorëzojë një program të realizimit të kontratës që do të aprovohet nga autoriteti kontraktues. Ky program do të përmbarë së paku këto:

- i) rendin sipas të cilët Furnizuesi propozon të realizohet kontrata, duke përfshirë dizajnin, prodhimin, dorëzimin në vend të pranimit, instalimin, testimin dhe komisionimin; dhe
- ii) të dhëna dhe informata të tjera të cilat mund t'i kërkojë me arsyet e autoritetit kontraktues.

11.2 KVK do të saktësojnë limitin kohor brenda të cilët programi i realizimit duhet t'i dorëzohet për aprovim autoriteti kontraktues dhe afatin e fundit për aprovimin e Autoritetit Kontraktues. Aprovimi i programit nga autoriteti kontraktues nuk e liron Furnizuesi nga obligimet e tij sipas kontratës.

11.3 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin te njostoj vendimin e tij te aprovimit i përmendur ne Nenin 11.2 brenda afateve te përmendura ne kontratë programi i tillë i realizimit duhet te konsiderohet i aprovuar me kalimin e afateve. Ne qofte se nuk ka afat te caktuar, ato do te konsiderohet te aprovuar 30 dite pas pranimit.

11.4 Asnjë ndryshim material në program nuk mund të bëhet pa aprovimin e autoritetit kontraktues. Megjithatë, nëse progresi i realizimit të kontratës nuk bëhet sipas programit, autoriteti kontraktues mund ta udhëzojë Furnizuesin që ta ripunojë programin dhe ta dorëzojë programin e ripunuar për aprovim te ai.

11.5 Para pranimit të perkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi duhet të furnizoj me manualet e funksionimit dhe mirëmbajtjes së bashku me vizatime, të cilat do të janë në detaje të tillë që do të mundësoj Autoritetit Kontraktues operimin, mirëmbajtjen, rregullimin dhe riparimin e të gjitha pjesëve të furnizimeve. Përveç nëse është përektuar ndryshe në KVK, manualet dhe vizatimet do të janë në gjithë kontratës dhe në forma dhe numrat të tillë të deklaruara në kontratë. Furnizimet nuk do të konsiderohen të përfunduara me qëllim të pranimit të perkohshëm deri sa manualet dhe vizatime e tillë janë furnizuar Autoritetit Kontraktues

Neni 12 Marrëveshjet tatimore dhe doganore

12.1 Duke iu nënshtruar dispozitave të tjera të përektuara në KVK, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve të pullës, taksat e licencave, tarifat doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara në vendin e dorëzimit, siç është përektuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 13 Patentat dhe licencat

13.1 Përveç në rastet kur është paraparë ndryshe në KVK, Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 14 Periudha e ekzekutimit të detyrate

14.1 Periudha e ekzekutimit të detyrate do të fillojë në datën e fiksuar në pajtim me Nenin 2, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 15.

14.2 Përveç kur palët pajtohen ndryshe, realizimi i kontratës duhet të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Furnizuesi ka të drejtë të mos e realizojë kontraten dhe të marrë përfundimin e saj apo kompensimin për dëmin që ka pësuar. Furnizuesit do ta humb këtë të drejtë përveç nëse ai e ushton atë brenda 30 ditëve

nga data e skadimit tē periudhës 90 ditësh.

14.3 Nëse mundësohen periudhat e ndara tē realizimit pér sasi tē ndara, këto periudha nuk do tē mblidhen në rastet kur një Furnizuesi i jepen më shumë se një sasi.

Neni 15 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

15.1 Furnizues mund tē kërkojë zgjatje tē periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do tē vonohet, pér ndonjëvën nga këto arsyec:

- a) Autoriteti kontraktues porosit furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte tē jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund tē ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, tē cilat nuk kanë mundur tē parashihen në mënyrë tē mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit tē furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/oze instalimit tē furnizimeve që nuk janë pér shkak tē gabimit tē Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte tē përgjithshme dhe tē cilat nuk janë pér shkak tē gabimit tē Furnizuesit.

15.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund tē ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se pér qëllim tē bëjë kërkesë pér zgjatje tē periudhës së realizimit pér tē cilën ai konsideron se ka tē drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjeter ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues tē dhëna gjithëpërfshirese ashtu që tē mund tē kontrollohet kërkesa.

15.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim pér furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje tē periudhës së realizimit nëse mund tē arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta pér zgjatje tē periudhës.

Neni 16 Vonesat e ekzekutimit

16.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose tē gjitha mallrat ose tē realizojë shërbimet brenda limiteve kohore tē specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera tē tij sipas kontratës, do tē ketë tē drejtë, pér secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit tē periudhës së kontratës dhe datës aktuale tē përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara tē barabarta me 0.25% në ditë tē vlerës së furnizimeve tē pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % tē vlerës totale tē kontratës.

16.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm tē furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara tē parapara në paragrafin 16.1 do tē llogariten në bazë tē vlerës totale tē kontratës

16.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar tē drejtën tē kërkojë së paku 10 % tē vlerës së kontratës ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

- tē konfiskojë garancinë e realizimit;
- tē ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do tē ketë tē drejtë pér kompensim; dhe
- tē hyjë në një kontratë me një palë tē tretë pér dhënien e pjesës së mbetur tē furnizimeve. Furnizuesi nuk do tē paguhet pér këtë pjesë tē kontratës. Furnizuesi gjithashtu do tē jetë i detyruar tē paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi tij.

Neni 17 Suspendimi

17.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që tē pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar pér dorëzim në programin e realizimit ose, nëse nuk është specifikuar koha, në kohën kur ato duhet tē dorëzohen; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

17.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do tē mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjeter, nga përkqësimi, humbja apo dëmtimi pér aq sa tē jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

17.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do t'i marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- është i nevojshëm për arsyet e kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjesë të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

17.4 Furnizues nuk do t'i ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përvç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

17.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do t'i përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do t'i bëhen nga Furnizues përkicati me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

17.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njostuar autoritetin kontraktues, mund t'i kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose t'i ndërpresë kontratën.

17.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përbajtjesore, parregullsive ose mashtimit, Autoriteti kontraktues do t'i pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund t'i refuzojë t'i bëje pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcione me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtimit.

17.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që t'i verifikohet nëse gabimet përbajtjesore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund t'i konfirmohen, realizimi i kontratës do t'i rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përbajtjesore ose parregullsitë do t'i jenë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitive tregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund t'i shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 18 Cilësia e furnizimeve

18.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikit teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe t'i janë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, t'i cilat duhet t'i mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

18.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet t'i bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi i për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do t'i saklësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuar për këtë pranim sipas kontratës dhe t'i tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do t'i bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuara në kërkesë duhet t'i certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se t'u inkorporohen në furnizime.

18.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do t'i inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do t'i furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund t'i refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet t'i ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do t'i pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që t'i jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 19 Inspektimi dhe testimi

19. Furnizues do t'i sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimit me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që t'i paraqesë ndonjë arsyet përvonesë.

19.2 Autoriteti kontraktues do t'i ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe t'i kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimi apo prodhimit të çfarëdo artikullit që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që t'i përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do t'i bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimit apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

19.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizues do t'i:

- I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohë t'i arsyeshme në vendin ku do t'i realizohen testimet.

19.4 Nëse përsaqësuesi i Autoriteti Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përvç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, t'i vazhdojë testimin, i cili do t'i konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuara si duhet t'i rezultateve të

testit te Autoriteti kontraktues, nese nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

19.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpermendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

19.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimt do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do t'ë janë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.

19.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimt.

Neni 20 Parimet të përgjithshme të pagesave

20.1 Pagesat do t'ë bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës qe duhet t'i behet Furnizues sipas kësaj Kontrate do te specifikohen ne KVK.

20.2 Pagesat qe duhet te bëhen sipas fakturës se lëshuar nga Furnizues do t'ë bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. i njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet t'ë përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

20.3 Shumat duhet t'ë paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do t'ë jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do t'ë jetë e pranueshme nese nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

20.4 Periudha prej 30-ditësh mund t'ë pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund t'ë plotësohet sepse shuma nuk do t'ë paguhet për shak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund t'ë mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund t'ë bëhet një inspektim i menjëherëshëm për qëllim t'ë kontrollimeve tjera. Furnizues do t'ë jepë sqarime, modifikime apo informata t'ë tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do t'ë llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

20.5 Pasi që t'ë ketë kusuar afati i fundit i dhënë në Nenin 20.3, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, t'ë kërkojë interesin për pagesë t'ë vonuar me normë t'ë re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë t'ë muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë t'ë përqindjes. Interesi për pagesë t'ë vonuar do t'ë zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së asatit t'ë fundit t'ë pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

20.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 20.3 do t'i japin t'ë drejtë Furnizuesit që ose t'ë mos e realizojë kontraten, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 21 Dorëzimi

21.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do t'ë janë në përgjegjësi t'ë Furnizuesit deri në pranimin e tyre t'ë përkohshëm.

21.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për t'ë parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet t'ë jetë i mjaftueshëm për t'ë përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, eksponimin në temperaturë ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nese është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje t'ë rendë në të gjitha pikat gjatë transitit.

21.3 Paketimi, shënim i dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet t'ë janë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë t'ë hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund t'ë urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

21.4 Asnjë furnizim nuk do t'ë transportohet as t'ë dorëzohet në vendin e pranimit derisa furnizuesi t'ë ketë pranuar urdhrrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do t'ë jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimit t'ë gjitha furnizimeve dhe pajisjeve t'ë furnizuesit, që janë t'ë nevojshme për qëllime t'ë kontratës.

21.5 Dorëzimi duhet t'ë konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për t'ë dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 22 Operacionet e verifikimit

22.1 Furnizimet nuk do t'ë pranohen derisa t'ë janë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime t'ë Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund t'ë realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhc/ose në destinimin final t'ë mallrave.

22.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit t'ë dorëzimit t'ë furnizimeve dhe para se t'ë merren furnizimet, duhet t'ë ketë fuqinë që t'ë urdhërojë ose t'ë vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohë osc kohësh sëç që specifikuar në urdhër, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontraten;
 - b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
 - c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjesëshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontraten;
 - d) që puna e bërrë ose mallrat e dorëzuar apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontraten, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

22.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defekjet e specifikuara. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhreve, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerrë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbsrcë nga paratë që do të paguhën ose të cilat do të bëhen obligim për t'i paguar Furnizuesit.

22.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimit, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

Neni 23 Pranimi i përkohshëm

23.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të janë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkua, dhe të janë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

23.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm atëherë kur furnizimet të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njërsës nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përvç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
 - të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

23.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimit ose e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evituar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtaishme për pranim.

23.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përvçë në rastet kur certifikata e pranimit të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimit përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për se cilën pjesë.

23.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.

23.6 Pas pranimit të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmton dhe i heq strukturat e përkohshme dhë materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendies së vendit të pranimit sic kërkohen në kontratë.

Neni 24 Obligimet për garanci

24.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të janë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përvëç nesc kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshteria. Kjo garanci do të mbetej e vlefshme në atë mënyrë që saktësitet në KVK.

24.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose
 - b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
 - c) shfagen gjatë ndonjë inspekimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emr të tij.

24.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirsojë desektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë

ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues, periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

24.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë k Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda asfatit kohor të paraparë në njostim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjeter për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhen ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontraten.

24.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhë në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 25 Shërbimet pas-shitjes

25.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njostimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lironë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërpërjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuarra dhe, pas ndërpërjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 26 Pranimi përfundimtar

26.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të janë zgjidhur të gjitha defektit apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 24 të janë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

26.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

26.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natura dhe masa e obligimeve të tillë do të përcaktohen duke iu referuar dispozitive të kontratës.

Neni 27 Shkelja e kontratës

27.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

27.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërpërjen e kontratës.

27.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

27.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 28 Ndërpërja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

28.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontraten në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përbajtjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;

- b) Furnizuesi dështon në përbmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res *judicata*;
- g) Furnizuesi është shpallur sajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res *judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjeter ilegal që i dëmon ton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjeter të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të finançuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktues;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përvèç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shifqet ndonjë paaftësi tjeter ligjore që i pengon realizimin të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të jepë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

28.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruejë ndonjë kontratë tjeter me një palë të trejë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përbmbushjen duhet të pushojë së ekzistuar menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të janë paraqitur tashmë.

28.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëherëm për ta përbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zgjegluar në minimum shpenzimet.

28.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Furnizuesit dhe parave që i ka børxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

28.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të janë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

28.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpert kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 29 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

29.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimi i nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

29.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjeter sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

29.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 29.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 30 Forca madhore

30.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi

i obligimeve tē tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn nō fuqi.

30.2 Pér qëllime tē këtij Neni, termi "forcë madhore" do tē thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit osc çregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin tē deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemië, rrëshqitjet e tokës, törmetet, shtëngatat, vërtëtimat, vërvshimet, crozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit tē palëve dhe nuk mund tē përballohet as me kujdesin e duhur.

30.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 16 dhe 28, Furnizuesi nuk do tē jetë i detyruar tē heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja pér shkak tē shkeljes nëse, dhe deri nō atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi pér tē realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje tē forcës madhore. Gjithashutu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 20.5 dhe 29, Autoriteti kontraktues nuk do tē jetë i detyruar tē paguajë interes pér pagesat e vonuara, pér mosrealizim ose pér ndërprerje nga Furnizuesi pér shkelje tē kontratës, nëse dhe deri nō atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit pér tē kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

30.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund tē ndikojë nō realizimin e obligimeve tē saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë tē dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do tē vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe tē angazhojë tē gjitha mjetet e arsyeshme alternative pér tē plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore tē mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do tē zbatojë mjete tē tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues

30.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit tē urdhreve tē autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit tē mjeteve alternative sipas nenit 30.4 shuma e saj do tē certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët duhet t'i bëjnë tē gjitha përpjekte pér tē zgjidhur nō mënyrë miqësore tē gjitha mosmarrëveshjet që mund tē ndodhin ndërmjet tyre. Sapo tē shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim pér qëndrimet e tyre nō mosmarrëveshje dhe pér ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e shih tē dobishme, palët do tē takohen dhe tē mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do tē i përgjigjet kërkësës pér zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha maksimale që jepet pér arritjen e kësaj zgjidhjeje do tē jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja pér tē arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon tē përgjigjet me kohë ndaj kërkësave pér zgjidhje, tē dyja palët do tē jenë tē lira tē vazhdojnë nō fazën e ardhshme tē procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore tē mosmarrëveshjes dështon, palët mund tē merren vesh tē përpiken tē pajtohen përmes institucionit tē specifikuar nō KVK. Nëse nuk mund tē arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit tē procedurës së pajtimit, secila palë do tē ketë tē drejtë tē vazhdojë nō fazën e ardhshme tē procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes

Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund tē arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore pér zgjidhje tē mosmarrëveshjes, secila palë mund tē kërkojë:

- ose vendim nga gjyqi; ose
- kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi nō pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin pér mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë :Gjuhët ne perdonim zyrtar
Siguria e ekzekutimit	8.1	NA
Sigurimi i tenderit	9.1	N/A
Cilësia e furnizimeve	16.2	Furnizimi dhe montimi i klimave duhet te jene sipas standardeve per furnizime te tilla dhe kualitative.
		Data e përfundimit e të gjitha furnizimeve do të jete deri me date 17.12.2024.
Inspektimi dhe testimi	17.2	Inspektimi do te behet nga menaxheri i kontrates dhe nga komisioni i pranimit. Menagjer i projektit nga AK eshte: Esheref Iftimani Menagjer mbikqyres i kontrates nga AK eshte: Resul Fetahu Menagjer i projektit nga OE eshte:Etnik Çitaku
Pagesa		Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i kontratës dhe Komisionit të pranimit- të përcjellura me raport. Pagesa do të kryhet në afate sa më të shkurtë kohor dhe jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit dhe evidentimit të faturës.
Dorëzimi	19.3	Do te behet ne objektin e K.K Dragashit
Dëmet e likuiduara	19.4	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25 % e Çmimit final të Kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës
Obligimet e garacionit	22.1	Periudha garantuese e defekteve është 24 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm. Dokumenti Polisa e sigurimit të kualiteti c lëshuar nga një Bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës 10 % vleren e

		<p>pergjithëshme të kontratës, me afat validiteti për prej 24 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm.</p>
	22.5	<p><i>[Specifikoni ndonjë obligim shtesë sipas garancisë]</i></p>
Shërbimet pas shitjes	23.1	<p><i>[Jepni detajet e shërbimit pas shitjes që Furnizuesi duhet të siguroj dhe përcaktoj raportin e sigurisë së ekzekutimit të caktuar për këtë aktivitet]</i></p>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	<p>Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë së Drejtësisë</p>
Zgjidhja mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

LISTA për furnizim me material hixhenik 2024

Nr	EMRI I ARTIKULLIT	Pershkrimi	Njësie	Sasia	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali me TVSH- €	
1	Air Wick-aroma mbushes /Paketimi 250ml	Mbushes per Air Wick-aroma per aparat. Njësie /Paketimi 250ml	Copë	40	5.90	0.90	36.00 ✓
2	Aparat me mbushes)	Air Wick-aroma Komplet (Njësie/Paketimi 250 ml.	Copë	15	0.65	0.65	88.50
3	Brusha për WC me mbajtës	Brusha për WC me mbajtës plastike..	Copë	80	0.80	0.80	52.00
4	Brushë për Xhamam	Brusha të Xhamave, brusha speciale për pastrimin e xhamave.	Copë	50	0.75	0.75	40.00
5	Dezinfektues për Toalete dhe Banjo	Dezinfektues për Toalete dhe Banjo, Gell 750 ml (Domestos i ose ekivalent)	Copë	200	2.80	2.80	150.00
6	Doreza	Doreza lateks jo steril. Njësie /Paketimi 1 *100 copë.	Paketimi	50	0.40	0.40	20.00
7	Doreza higjenike të trasha	Doreza për pastrim - plastike, te trasha , te mbrojtura nga uji, Madhësia te mesme .	Palië	50	1.50	1.50	180.00
8	Fshisë dore e thjeshtë	Fshisë dore e thjeshtë - me fije kahte, me bishë të gjatë	Copë	70	0.80	0.80	56.00
9	Zbardues	Zbardues për pastrimi toalet wc 1 l	Copë	200	0.65	0.65	130.00
10	Thartina	Thartina:NH2 Për pastrimi e toaletë 1l.	Copë	100	1.00	1.00	100.00
11	Fshisë e thjeshtë dore e plastikës	Fshisë dore e thjeshtë - me fije plastike me bishë të gjatë	Copë	100	1.00	1.00	100.00
12	Gjoger	Gjoger, me fije të gjata,tip Balerinë me bishë të gjatë.	Copë	60	1.30	1.30	78.00
13	Gjoger	Gjoger, papuqe me material bambuk 100% me bishë të gjatë,	Copë	60	0.95	0.95	57.00
14	Kovë Plastike	Kofë e plastikes, 10-15 llithësh	Copë	50	0.70	0.70	35.00
15	Kovë për Gjoger	Kovë me shtrudhëse për Gjogjet me fije-Balerinë	Copë	50	1.75	1.75	87.50
16	Lecka	Lecka nga lëkura e kualitetit të lartë	Copë	10	0.10	0.10	1.00
17	Lecke për pastrimin e Monitorit të PC	Lecke për pastrimin e Monitorëve të kompjuterëve	Copë	10	0.45	0.45	135.00
18	Leter kuzhine	Leter kuzhine - e trashë ne rollin, përafërsht 30cm e Elere.	Kompleti	300	0.84	0.84	252.00
19	Leter Tualeti	Njësie/paketimi (2x1) Leter Tualeti ne rollin: Leter clësore, e butem dy shtrresore , ngjyre e bardhe Njësie/paketimi (8+2)	Kompleti	650			546.00

20	Mini Shpuza	Mini Shpuza për pastrim. Dim 4x9x2,5 cm	Copë	150	0.06	9.00
21	Pastrues krem për spërfaqe	Pastrues krem për spërfaqe – krem i lëngët. I liron dhe amoni. Benjo, kuzhine, ne spërfaqe te qeramikës, pilaka. Ph. rate 10–12. Eco non-toxic. Largues i gëllqerat. Pastron spërfaqet pa gërviste. Njësie/paketimi 1000 ml	Copë	100	0.80	80.00
22	Pastrues për çelik	Pastrues për çelik - Pastron: çelikun, kromin, nikelin, dhe i shkëllqen ato. Heq njollat e ujut nga spërfajtja. Shkalla Ph 8.00-9.00. I gatshme për përdorim. Njësie/paketimi me pompë 500ml.	Copë	100	0.85	85.00
23	Duar	Sapun i aromatik i ngurtë për Duart.	Copë	300	0.23	69.00
24	Sprej anti-insekte	Sprej kunder insekteve, për eliminimin te insekteve – boce 40 ml	Copë	40	1.00	40.00
25	Sprej për Xhamia	Sprej për Xhamia i specialituar, për pastrimin e xhamave, sprej me pompë 750 ml	Copë	250	0.60	150.00
26	Shampoon për dysheme	Shampoon për dysheme - standard për pilaka me qeramika. Shkalla Ph 10-12. Eco jo-toksike. Largues i gëllqerat. Pastron spërfaqet pa gërviste. Njësie/paketimi 1000 ml	Copë	250	0.60	150.00
27	Shampoon për duar	Shampoon për duar fresh, me aromë 1000 ml	Copë	300	0.60	180.00
28	Shpuza te madh	Shpuza me 2 ane, (njëra e bute kurse tjera e vrashdet) 1000 ml përbën mbeturina antibakteriale 35 literësh me ngjyre të zare, i përshtatshëm për vendosjen në shportë 6x50cm. Njësie / Paketimi 1/10	Copë	250	0.07	17.50
29	Thasë PVC	Thase PVC përmbyturina antibakteriale 170 litërsish me ngjyre te zezë i përshtatshëm për vendosjen në shportë 110x70cm. Njësie / Paketimi 1/10	Kompleti	250	0.30	75.00
30	Thasë PVC	Thase PVC përmbyturina antibakteriale 170 litërsish me ngjyre te zezë i përshtatshëm për vendosjen në shportë 110x70cm. Njësie / Paketimi 1/10	Kompleti	200	0.65	130.00
31	Thasë PVC	Thase PVC përmbyturina antibakteriale 240 litërsish me ngjyre te zezë i përshtatshëm për vendosjen në shportë 110x70cm. Njësie / Paketimi 1/10	Kompleti	200	1.00	200.00
32	Deterxhent për lavatrice	Detergjent i cileses se larte me re perberes 3x1	Thas	30	2.45	73.50
35	Cif	Cif për pastrimi tociate sanitari 750 gr	Copë	100	0.80	80.00
34	Vim pluhur	Vim për pastrimi toalete 500 gr		100	0.45	45.00
TOTAL me TVSH						3,366.50



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragash / Dragas Municipality



02 - Kryetari i Komunes
Nr. 400/1-50646/24

Dt. 26.11.2024

Dragash

Kryetari I Komunes, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vjetqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), si dhe ne pajtim me nenin 81 te Ligjit Nr.04/L-042 per Prokurim Publik ne Republikën e Kosovës, si dhe Rregullave dhe Urdhreses Operativ per Prokurim Publik/Nr, A01, nxjerre:

V E N D I M

Caktohet menaxheri i kontrates dhe mbikqyresi ne realizimin e kontrates per •110• Furnizimi me material higjienik (material pastrimi) ne Komunën e Dragashit me numër identifikues: 621-24-11438-1-3-6, dhe nr, te mbrendshem 621-2024-110-136.


Esheref Iftimani - caktohet menagjer I kontrates,

Resul Fetahu-Mbikqyres I drejtoperdrejt I menagjerit te kontrates

Menaxheri I kontrates, obligohet qe te hartoje nje plan te menaxhimit te Kontrates, duke perdorur formularin standard te miratuar nga KRPP, I cili duhet te nenshkruhet nga ana e te dy paleve(Menaxherit te Kontrates se AK dhe Menagjerit te Kontrates se OP) para inicimit te zbatimit te kontrates dhe nje kopje te nenshkruar te planit per menaxhimin e kontrates do ta percjelle tek departamenti I prokurimit.

1. Menagjeri I kontrates e menagjon kontraten deri ne pranimin e pote te puneve te kerkuara-kontraktuara, respektivisht deri ne permbylljen e kontrates.
2. Ky vendim hyn ne fuqi diten e nenshkrimit

Kryetari I Komunes:



Vendimi u dërgohet: menagjerit te projektit,
Mbikqyresit te kontrates,
Zyres se Prokurimit,
Drejtitorit te Drejtorisë perkatese,
Arkivit te Komunes(kryetarit).